



VENDIM

NR. 198, DATË 25.10.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E AMA-S, NR. 98, DATË 07.06.2017, "PËR MIRATIMIN E NUMRIT LOGJIK TË PROGRAMIT TË SHËRBIMEVE PROGRAMORE KOMBËTARE TË PËRGJITHSHME DHE SHËRBIMEVE PROGRAMORE PRIVATE RAJONALE/LOKALE"

Në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe rregullores "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për renditjen e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete numerike", miratuar me vendimin nr. 218, datë 12.10.2016 të AMA-s, i ndryshuar, pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit të Vlerësimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në listën bashkëlidhur vendimit të AMA-s, nr. 98, datë 07.06.2017, "Për miratimin e numrit logjik të programit të shërbimeve programore kombëtare të përgjithshme dhe shërbimeve programore private rajonale/lokale", si më poshtë:

NLP	SHËRBIMI PROGRAMOR
4	Tv Klan
5	Tv Top Channel

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian SALA
Zëvendëskryetar: Sami NEZAJ
Anëtarë: Agron GJEKMARKAJ
Gledis GJIPALI
Piro MISHA
Suela MUSTA
Zylyftar BREGU